

VENDIM
Nr.80, datë 25.10.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TË
USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 13 pika 2 paragrafi “d” të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për dhënie e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.71, datë 11.9.2002, ndryshuar me vendimin nr.3, datë 26.1.2005, pas pikës 17.6 të saj të shtohen dispozitat e mëposhtme:

17.7 Transferimi i së drejtës së pronësisë të një aksionari indirekt në masën dhjetë për qind ose më shumë të kapitalit të bankës ose të aksioneve të saj me të drejta vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në drejtimin a politikat e saj, bëhet vetëm pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë.

17.8 Për transferimin e së drejtës së pronësisë sipas pikës 17.7 të kësaj rregulloreje, banka duhet të kërkojë miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

17.9 Kërkesa e paraqitur në Bankën e Shqipërisë shoqërohet me dokumentacionin për aksionarin indirekt të bankës, si më poshtë:

a) për aksionarin indirekt, i cili është person juridik, kërkohet dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 4.2.1., shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj rregulloreje;

b) për aksionarin indirekt, i cili është person fizik tregtar ose individ, kërkohet dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 4.2.2 të kësaj rregulloreje;

c) për aksionarin indirekt, i cili është bankë e huaj, kërkohet dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 4.2.1 paragrafi 1 shkronja “a” dhe “b” dhe të pikës 4.2.3 paragrafi 1 shkronjat “a” dhe “b” dhe paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, si dhe pëlqimi për këtë transferim i dhënë nga autoriteti licencues dhe mbikëqyrës i vendit ku banka ka selinë dhe çdo autoritet tjetër mbikëqyrës që duhet të miratojë transaksionin (nëse ka).

Përveç dokumentacionit të kërkuar sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike, kërkesa për miratim nga Banka e Shqipërisë shoqërohet në çdo rast edhe me një kopje të noterizuar të aktmarrëveshjes së nënshkruar, midis dy subjekteve për transferimin e titujve të pronësisë mbi aksionet, të cilat krijojnë pjesëmarrje influencuese.

17.10 Banka e Shqipërisë jep miratimin ose refuzon transferimin e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit indirekt në kapitalin aksionar të bankës jo më vonë se dy muaj nga data kur dokumentacioni është paraqitur i plotë.

17.11 Pavarësisht nga përcaktimet në paragrafin 17.9 të këtij neni, mbështetur në materialin dhe në propozimin e hartuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes dhe kur ekzistojnë vështirësi të argumentuara për sigurimin e të gjithë dokumentacionit dhe të analizave që kërkohen në paragrafin 17.9 pika “c” të këtij neni, Këshilli Mbikëqyrës mund të vendosë përjashtimin nga disa prej kërkesave të përcaktuara në paragrafin 17.9, pika “c” të këtij neni, në rastin kur kemi të bëjmë me një bankë që:

a) e ka selinë e saj qendrore në një prej vendeve anëtare të Bashkimit Europian; dhe

b) gëzon një reputacion të mirë në tregjet ndërkombëtare dhe një gjendje të mirë financiare sipas vlerësimeve të shoqërive të specializuara të renditjes;

c) është marrë pëlqimi i autoriteteve të huaja mbikëqyrëse për kryerjen e transaksionit, në bazë të të cilit banka e huaj fiton pjesëmarrjen në kapitalin e bankës që vepron në Shqipëri.

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani